



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 59

Datë: 13. 09. 2021. Ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvij, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së.**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 56 dhe 57/2021.**
- 3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatit
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.
- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore;**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Doracakut të Trajnimit për zgjedhjet lokale 2021,

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga verifikimi i aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës në katër komunat: Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë,
- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndarjen dhe paketimin e fletëvotimeve për votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta (kategoria e dytë e VNV-ve).
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për zgjedhjet lokale 2021.

6. Të ndryshme

Hyrje z. Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi: E hapim mbledhjen e 59-të të KQZ-së, jemi të gjithë anëtarët prezentë. Para vetes e keni agjendën, do të thotë e kemi shqyrtimin dhe miratimin e dy procesverbaleve 56 dhe 57, aktivitetet e Sekretariatit, aktivitetet e zyrës me dy rekomandime ,certifikim i kandidatëve, akreditimi I vëzhguesve, raporti i këshillave...A ka dikush diçka tjetër me shtuar ?

Florian Dushi: Në kuadër të rendi të ditës është e rëndësishme që ne si KQZ të njoftohemi lidhur me takimin që keni pas me presidenten e Kosovës gjatë javës së kaluar, takim për të cilin ne e kemi mësuar nga mediat, ose po e fusim si pikë e veçantë e rendit të ditës ose në kuadër të hyrjes që ju zakonisht e bëni por konsideroj që është mirë të njoftohemi si KQZ, nëse eventualisht ka pas kërkesa ose ka qenë takim me karakter njoftues...

Arianit Elshani: Kryesues ishte realisht e njëjta çështje që desha ta diskutojmë bashkërisht në qoftë se është kërkuar nga ne nëse jemi të gatshëm lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për shkak të rrethanave dhe pra në qoftë se e keni diskutuar këtë si temë diskutimi dhe lidhur me masat që duhet të marrim si KQZ edhe për mbarëvajtjen e fushatës edhe (nuk dëgjohet)...

Ylli Buleshkaj: Në qoftë se është e mundur e kisha propozuar shtimin e një nënpike të pika aktivitetet e zyrës “shqyrtimi dhe miratimi për de certifikim të kandidatit”, sot kemi pranuar nga KGJK një informatë që një kandidat më nuk l plotëson kushtet për të qenë kandidat, i njëjti sipas paragrafit 29 pika 4 duhet të de certifikohet, rekomandimin e keni të bashkangjitur.....

Kreshnik Radoniqi: Atëherë me këto dy ndryshime, do të thotë njoftimin për takimin tim me presidenten dhe de certifikimin e kandidatit, kush është për ?

Me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim të mbledhjes, kryetari Radoniqi referoi mbi takimin në Presidencë. Ai, tha se, unë jam takuar me presidenten, dhe takimi ka qenë zyrtar. Ka qenë një takim i kërkuar nga unë. Qëllimi i takimit ka qenë për hapësirat e objektin, për staf të Sekretariatit. Ne e kemi marrë një vendim prej ish ministrit Veliu në kohën kur, unë nuk kam qenë kryesues që aneksi i kësaj ndërtese që gjendet në anën e djathtë të

ndërtesës t'i jepet KQZ-së si pjesë e ndërtesës për nevojat e stafit. Ne kemi komunikuar me Ministrinë e MPB-së por mund të them që ne vetëm kemi dërguar kërkesa për këtë ndërtesë dhe, nuk kemi pranuar asnjëherë asnjë përgjigje prej kohës kur është marrë ai vendim. Qëllimi im ka qenë vetëm me kërkuar nga presidentja që të ketë një komunikim me ministrin se, ata nuk na përgjigjen lidhur me këtë objekt. Ne, i kemi shumë kushtet e pavolitshme në këtë ndërtesë ku jemi, sidomos në këtë gjendje të pandemisë ku duhet me punua 10-15 persona në zyrë, sidomos në zyrën e regjistrimit të partive politike e cila zyre ka raste kur punon me 3 ndërrime e në secilin ndërrim, janë 10-15 persona që punojnë në atë zyre.

Çështje tjetër që është diskutuar, ka qenë nevoja për me i vaksinuar stafin që do të punojnë ditën e zgjedhjeve dhe për këtë çështje kam kërkuar nga presidentja (kërkesën ia kemi dërgu me shkrim Ministrisë së Shëndësisë) që të ketë mirëkuptim dhe të kërkoj takim me ministrin e shëndetësisë për vaksinimin e diku 25.000 - 30.000 persona që do të jenë të angazhuar të punojnë ditën e zgjedhjeve.

Por, është ngritë edhe çështja e shtyrjes apo zvogëlimit të fushatës zgjedhore! Unë, tha z. Radoniqi, në këtë çështje nuk kam dhënë mendim, as nuk jam marrë me atë çështje sepse, kam thënë se kërkesë nuk kemi për me e shkurtuar fushatën dhe, është çështje ligjore kohëzgjatja e fushatës. Ne si KQZ, të paktën unë në lexim të ligjit, nuk kam parë ndonjë arsye që të marrim ndonjë vendim për zvogëlimin e fushatës përveç, nëse kemi zgjedhje të jashtëzakonshme. Në zgjedhje të rregullta, nuk kemi ndonjë dispozitë e cila thotë që mund ta shkurtojmë fushatën...

Sa i përket shtyrjes së datës së zgjedhjeve, tha z. Radoniqi, ajo a. absolutisht nuk është në kompetencë timen as të KQZ-së, as nuk e parasheh ligji këtë çështje...

Në qoftë se nuk ka pyetje tjera vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit 56 dhe 57

A ka dikush diçka ? Unë kisha pas diçka vetëm në një pikë: kur i kemi de certifikuar dy kandidatë për Klinë, në procesverbal nuk thotë de certifikim por certifikim, këtë ndoshta duhet me e përmirësuar nëse ka dikush diçka tjetër lidhur me dy procesverbalet

Atëherë, kush është për miratimin e dy procesverbaleve 56 dhe 57 ?

Me vota unanime miratohen procesverbalet 56, 57/ 2021 nga mbledhjet e KQZ-së

2. Aktivitetet e Sekretariatit

Burim Ahmetaj: Sekretariati, është në procesin e përgatitjesh për zgjedhje komunale. Ndër aktivitetet kryesore, Sekretariati ka dizajnuar fletëvotimet dhe broshurat për zgjedhje dhe po ashtu, ka finalizuar të gjitha ndryshimet që janë bërë në doracakun e procedurave të votimit dhe numërimit, si dhe ka përgatitur numrin e fletëvotimeve që do të dorëzohen në secilin fletëvotim në tërë territorin e RKS. Po ashtu, krahas shumë punëve dhe aktiviteteve të shërbimit votues; Sekretariati ka përfunduar aktivitetet që lidhen me regjistrimin e votuesve jashtë vendit dhe aktivitetet e ndërrimit të qendrave të votimit; largimi i të gjithë personave që nuk plotësojnë kriteret juridike; listën e votuesve jashtë vendit...

Sekretariati, është në fazën e dërgimit të ftesave subjekteve politike për ti nominuar kandidatët për anëtarë të këshillave të vendvotimit, si dhe jemi në prag të zhvillimit të fushatës zgjedhore pra, këtë javë do të fillojë procesi i printimit të fletëvotimeve për kryetar komune dhe kuvend komunal, si dhe broshura me emra të kandidatëve. Krahas ftesës për nominimet për anëtare të këshillave të vendvotimeve,

Sekretariati po përgatitet edhe për masat anticovid të ndërmarra nga qeveria. Duke i respektuar këto masa, ne do t'i vendosim katër kritere apo kërkesa për masa anticovid. Sekretariati, ka publikuar listën e qendrave të votimit në ueb faqen zyrtare të KQZ-së dhe krahas kësaj, kemi mbajtur edhe një takim koordinues të sigurisë me institucionet bashkëpunuese që, kanë nënshkruar memorandumit e mirëkuptimit për zgjedhjet, ndërsa për qendrën e votimit salla 1 tetori që aktualisht është qendër e vaksinimit të cilën e shfrytëzon Ministria e Shëndetësisë. Sekretariati ka identifikuar lokacionet për transferimin e qendrës së votimit 12E në Prishtinë e cila sallë përdoret si qendër e vaksinimit...

Kreshnik Radoniqi : A ka dikush diçka lidhur me raportin e z. Ahmetaj ?

Sami Kurteshi: Nga kjo që dëgjova nuk ka diçka të jashtëzakonshme, unë mendoj ndoshta ka me qenë e nevojshme dua të them e domosdoshme që, KQZ të marrë një vendim që asnjë person i angazhuar nga KQZ apo subjekti politik që nuk i plotëson kriteret sipas rekomandimeve të IKSHPK-së, të mos lejohet që të mos punojë.....(nuk dëgjohet), dhe të përdoren mjetet mbrojtëse.....

Arianit Elshani : Si KQZ, kemi marrë një vendim lidhur me masat që duhet respektuar në qendrat e votimit andaj, pajtohem me këtë kërkesë që ne si KQZ ta draftojmë një udhëzues ose të rishikojmë edhe njëherë udhëzuesin që kemi miratuar në të kaluarën: të përditësohet karshi rrethanave të reja dhe të kërkohet nga të gjithë anëtarët e këshillave të vendvotimit, duke përfshirë edhe vëzhguesit që t'i plotësojnë këto kritere të cilat na janë rekomanduar dhe neve si Sekretariat...

Florian Dushi : Ajo që unë desha me ngritë është ndërlidhet edhe me këtë që është aktuale pra me kujdesin që ne si institucion sepse nuk kemi kurrfarë përjashtimi që duhet të bëjmë në kuptimin e respektimit të masave të cilat janë miratuar nga qeveria dhe nga institucionet tjera kompetente prandaj unë javë më parë kam kërkuar nga Sekretariati që ta kemi një plan të detajuar apo një udhëzues i cili paska ekzistuar në zgjedhjet e mëparshme të cilin qysh tash se shumë shpejtë do të fillojmë edhe me trajnimet qysh tash do duhej ta kemi dhe tua shpërndajmë edhe KKZ-ve sepse është mirë që të sigurohemi që të gjitha segmentet e organizimit të institucionit tonë do të respektojnë një udhëzues i cili do të jetë në përputhje të plotë me masat e miratuara që kanë për qëllim parandalimin e përhapjes më tutje të këtij virusi. Kjo, është me rëndësi për institucionin tonë ,pjesa e fushatës unë mendoj që subjektet politike mund të bëjnë fushatë më shkurtë ose më gjatë por unë konsideroj që edhe ato nuk bëjnë kurrfarë përjashtimi.

Prandaj, tha z. Dushi, masat që janë të barabarta aktualisht dhe të cilat janë në fuqi pavarësisht ditës kur do të filloj fushata zgjedhore subjektet politike gjithsesi mbështetësit e tyre dhe kandidatët e tyre janë të obliguar që ti respektojnë këto masa me qëllim të vetëm që të mos ngritët numri; Prapë po kthehem te thelbi: është me rëndësi që ne si institucion të marrim të gjitha masat e nevojshme në kuptimin që stafi jonë njerëzit që do të angazhohen në këto zgjedhje në forma të ndryshme të respektojnë masat e miratuara

Ilir Gashi: Ne, e diskutuam edhe në mbledhjen e kaluar për sa i përket masave, domosdoshmërisht, përveç pjesës tjetër të përgatitjes së procesit ngarkohemi edhe mbarëvajtjes sa i përket respektimit të masave në raport me pandeminë. Pra, ne jemi dakorduar në mbledhjen e kaluar që një qarkore me ua përcjell subjekteve politike për t'i sensibilizuar dhe me i informuar sepse, në ditën e zgjedhjeve duhet që të gjithë personat e angazhuar të kenë dëshmi të vaksinimit...

Alim Rama: Një kriter që e kemi përdorë në zgjedhjet e Podujevës është që, një subjekt nuk mundet me pas më shumë se një vëzhgues, dhe i takon subjektit politik që ti ndërroj apo t'i zëvendësoj...

Ilir Gashi: Ligjim e thotë qartë që jo më shumë se 2 vëzhgues...! Kryesuesi, në bazë të rrethanave mund të vendosë se sa vëzhgues duhet të jenë; Zakonisht tash edhe për shkak të pandemisë mirëpo formula duhet të jetë formulë që vendoset nga ne për faktin se mundet me u keqpërdorë pastaj nga kryesueset eventualisht e këtu mund të na dalin telashe pastaj gjatë ditës së votimit me ankesa të ndryshe se u largua dikush qëndroj më shumë e dikush më pak, varësisht se si e koordinon punën kryesuesi i vendvotimit në bashkëpunim me të tjerët kështu që formulën nëse e vendosim duhet të jetë formulë për të gjithë e njëjtë në qoftë se shkojmë me nga një vëzhgues për shkak të pandemisë atëherë kjo mbetet për gjithë kështuqë për ti ikur problemeve që mund të dalin në proces gjatë ditës

Kreshnik Radoniqi : Dikush diçka tjetër në lidhje me aktivitetet e Sekretariatit ?

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për certifikim të kandidatit:

Ylli Buleshkaj: Para se të fillojmë me pikat e radhës deshta të konfirmoj që kemi pranuar informata nga shërbimi votues se të gjithë kandidatët që kanë pas probleme me komunën ku kanë aplikuar tashmë janë në listën e komunave; të gjithë janë në komunat e tyre, po ashtu kemi filluar me pranuar shumë aplikacione për vëzhgimin e vetëm s'i informatë herën e kaluar kemi pas mbi 30.000, e zgjedhjet paraprake 36.000. Si vëzhgues, presim prapë t'i kemi rreth 30.000 - 36.0000.

Pika që e keni para jush, është shqyrtimi dhe miratimi për certifikim të kandidatit: ashtu, siç jeni informuar mbledhjen e fundit kandidati për kryetar komune në Pejë nga Partia Balliste ka ndërruar jetë, ju kemi dhënë kohë deri sot që ta dërgojnë kandidatin zëvendësues. Në qoftë se janë të interesuar ta bëjnë, e njëjta mundësi, i është lejuar sipas ligjit edhe partisë Demokratike të Kosovës për kandidatin për kryetar komune në Pejë...

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka lidhur me këtë, e hedh në votim: kush është për certifikimin e kandidates nga Partia Balliste për kryetare ?

Me vota unanime, certifikohet kandidatja e Partisë Balliste për zgjedhjet lokale 2021: Drena Podrimqaku

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhgueseve.

Ylli Buleshkaj : Për shkak të lidhjes logjike pikën që e shtuam tash e kisha futë tash nëse më lejohet është rekomandimi për de certifikim të kandidatit ,sot kemi pranuar një informacion nga KGJK-ja që një kandidat që e kemi certifikua më herët tash është gjendur se ka një vepër të formës së prerë në këtë mënyrë I pamundësohet qëndrimi si kandidat në zgjedhje ,fjala është për kandidatin Zharko Dejanoviq, partia politike nga e cila vjen ky kandidat të njëjtit kanë afat deri nesër që të japim emrin për zëvendësim apo të

bëjnë riradhitje në listën për kuvend komunal të Kllokotit kështu që, për shkak se ligji i pamundëson qëndrimin në garë rekomandoj që edhe KQZ të de certifikoj...

Kreshnik Radoniqi : Nëse nuk ka dikush diçka lidhur me këtë e hedh në votim: kush është për miratimin e rekomandimit për de certifikimin ?

Me vota unanime miratohet rekomandimi i zyrës për de certifikimin e kandidatit të Srpska Listes, Zharko Dejanović

Ylli Buleshkaj: Pika e radhës është: rekomandimi për akreditim të vëzhguesve për zgjedhje në mënyrë që të mos na grumbullohen shumë; në çdo mbledhje do të sjellim kështu, disa para jush kemi paraqitur rekomandimin për akreditim të vëzhguesve nga OJQ-ja vendore “Demokracia Plus” me 11 vëzhgues, pastaj është iniciativa qytetare “Bashkë për Shtërpcën” me 27 vëzhgues dhe, kandidati i pavarur Isa Elezaj ka aplikuar me listën prej 5 vëzhguesve, së bashku me vendimin për secilin rekomandim e keni edhe listën e vëzhguesve të secilit subjekt....

Kreshnik Radoniqi : Atëherë kush është për akreditimin e vëzhguesve të Demokracia Plus ?

Me vota unanime, akreditohet grupi i vëzhguesve të Demokracia Plus me 11 vëzhgues.

Ylli Buleshkaj: Të dytit, janë iniciativa qytetare Bashkë për Shtërpcën me 27 vëzhgues...

Kreshnik Radoniqi : Kush është për?

Me vota unanime akreditohet grupi i vëzhguesve të iniciativës qytetare Bashkë për Shtërpcën me 27 vëzhgues.

Ylli Buleshkaj : Ndërsa grupi i fundit është grupi i 5 vëzhguesve të kandidatit të pavarur Isa Elezaj.

Kreshnik Radoniqi : Kush është për?

Me vota unanime akreditohet grupi i vëzhguesve të kandidatit të pavarur Isa Elezaj me 5 vëzhgues.

7. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore;

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Doracakut të Trajnimit për zgjedhjet lokale 2021:

Arianit Elshani : Para vetës keni doracakun e trajnimit për zgjedhje lokale 2021, është një doracak që është trajtuar tash në Këshillin për Operacione Zgjedhore, realisht ka qenë i miratuar edhe më parë është përdorur edhe më parë për trajnimin e KVV-ve që, e sqaron në mënyrë të detajuar procesin e numërimit, procesin e paketimit, të gjitha aktivitetet që merren gjatë ditës së zgjedhjeve, para ditës së zgjedhjeve pas ditës së zgjedhjeve; po ashtu, e sqaron në mënyrë të detajuar këtë proces. Ne, jemi munduar që ta përditësojmë me vendimet e fundit që kemi marrë si KQZ lidhur me futjen e disa diagrameve të cilat, kemi konsideruar që është e nevojshme të sqarohen më shumë që ti kuptojmë sa më mirë, që të kemi sa më pak gabime, sa më pak lëshime në ditën e zgjedhjeve dhe tjetra që të ruhet çdo material në mënyrë që ne të ulim kostot e zgjedhjeve. Pra, në qoftë se e shihni nga faqja 53 e tutje, keni disa ndryshime më

përmbajtsore të cilët janë të hapat për numërimin e votave dhe kandidatëve ku vendimi lidhur me flikat që kemi marrë është përfshirë brenda doracakut.

Në fakt, sqarohen procedurat si do të shkojë i gjithë ai proces, pastaj në faqet e fundit i keni edhe vendimet të bashkangjitura të KOZ-së lidhur me lejimin e dokumenteve me afat të skaduar; edhe një shtojcë të cilën e kemi krijuar të re e cila është propozuar nga Sekretariati që formulari i dorëzim-pranimit të fletës llogaritëse të kandidatëve në mënyrë që KOZ-ja, ata persona që janë në këshill të vendvotimit, të jenë qartas të informuar se ku ka mbetur një flikë ose nëse ata e kanë atë flikë apo jo kështu që e vlerësojmë që është shumë e rëndësishme; Pastaj në QNR !

Andaj, tha z. Elshani, konsiderojmë që duhet të miratohet të njëjtën kohë si Këshill për Operacione Zgjedhore me propozimin edhe të z. Rama është kërkuar që për zgjedhjet e ardhshme të përgatitet një formë online një formë videotrajnimit, të mos jetë gjithçka vetëm e shkruar por që ti mundësojmë anëtarët e këshillave të vendvotimit në këtë rast komisionarët të trajnohen përmes videove që mund ti ndjekin edhe pas ditës së trajnimit dhe në mënyrë që ata ti kuptojnë mirë procedurat që do ti zhvillojnë gjatë ditës së votimit....Si KOZ, ne rekomandojmë që të aprovohet ky doracak...

Në kontekst të formatit informativ të Doracakut, të shqyrtimit dhe analizës për të pasur një dokument sa më përmbajtësorë, diskutuan dhe kontribuan: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Rifat Krasniq, Alim Rama, Čemailj Kurtiši, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj dhe Burim Ahmetaj.

Kreshnik Radoniqi: Ne rregull, e hedh në votim doracakun e trajnimit më të gjitha vrenjtet sugjerimet që u dhanë nga të gjithë anëtarët.

Kush është për? Më vota unanime votohet doracakun i trajnimit për Zgjedhje Lokale 2021 që do të thotë me të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet që u dhanë gjatë diskutimeve.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve nga verifikimi i aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës në katër komunit: Dragash, Suharekë, Junik dhe Mamushë:

Arianit Elshani: Faleminderit kryesues, KOZ-ë ka shqyrtuar rekomandimet që kanë ardhur nga sekretariati lidhur me verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës në katër komunit në Dragash, Suhareke, Junik dhe Mamushë ju kam raportuar edhe dy mbledhjet e kaluara lidhur me procesin e verifikimit pra në kuadër të mostrës prej 2% ne raport më këto komuna dhe nga ato dyshime që kemi pasur më komunën e Mamushes prej 245 aplikimeve sekretariati ka konstatuar që 54 prej tyre duhet të rekomandohen për largim nga lista votuese jashtë Kosovës të cilët kanë deklaruar përmes telefonit të cilët kanë treguar që nuk kanë aplikuar personalisht. Andaj, rekomandimi qartëson edhe për 3 persona nga komuna e Dragashit, 5 persona nga komuna e Suharekës dhe 6 persona nga komuna e Junikut të cilët, personalisht përmes telefonit kanë konfirmuar se, nuk kanë aplikuar për votim jashtë vendit.

Thirrjet telefonike janë zhvilluar ose gjate ose nga fundi i gushtit e deri të premtën më kërkesat për konfirmimin e gjithë këtyre aplikimeve ne kemi dyshuar ne ato numëruat e Dragashit, Suharekës, Junikut, ku në raport më popullsinë ka qene një numër i madh i aplikimeve për votim jashtë vendit mirëpo nga këto verifikime që janë bere ka rezultuar një numër i vogël i personave të cilët duhet të largohen nga lista votuese jashtë vendit pra ky është rekomandimi edhe i KOZ-ë prandaj rekomandojmë që të miratohet dhe

këta persona të hiqen dhe të gjitha këto aplikacione të procedohen për ne hetuesi dhe në institucionet e drejtësisë të merren më këto aplikacione të verifikojnë të shohin sakte se si kane ardhur ato të dhëna personale të atyre personave në KQZ-ë kush ka plotësuar në emër të tyre ato aplikacione dhe kush ka tentuar të manipulojë procesin zgjedhore në këto kohe. Faleminderit

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit z. Elshani, a ka dikush diçka lidhur më këtë pike? Pra atëherë e hedhim në votim kush është për miratimin e këtij rekomandimi? Më vota unanime miratohet rekomandimi nga verifikimi e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës me 4 komunat Dragash, Suhareke, Junik dhe Mamushe vazhdojmë më piken e tret të te KOZ-ë z. Elshani?

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndarjen dhe paketimin e fletëvotimeve për votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta (kategoria e dytë e VNV-ve):

Arianit Elshani : Faleminderit kryesues, një pike tjetër që kemi shqyrtuar si këshill është rekomandimi për ndarjen dhe paketimin e fletëvotimeve për votuesit me nevoja dhe me rrethana të veçanta për kategorinë e dytë. Siç, edhe e dimë, për zgjedhjet lokale Kosova është e ndarë në 38 zona zgjedhore dhe me qenë se kemi votues në hospitalizimë, njerëz të moshuar në shtëpi e caktuara për të moshuarit, persona me aftësi të zvogëluara të kujdesit shëndetësorë, të burgosurit që janë në burgje dhe të paraburgosurit që janë në qendrat e paraburgimit, ne si KQZ-ë duhet t'ua mundësojmë që në këto institucione ekipet mobile të shkojnë për t'ua mundësuar atyre votimin që, t'u mundësohet atyre që ta kenë para vetes fletëvotimin e komunës së tyre.

Andaj, këshilli dhe sekretariati ka marr vendim që këto fletëvotime për këta persona të printohen, pra të shtypen nga operatori ekonomik dhe të paktohen nga operatori ekonomik dhe të njëjtat, të i dorëzohen KQZ-së dhe KQZ-ë pastaj të transferoj në komisione komunale të zgjedhjeve; Kemi konsideruar që në mënyre që ta ulim tendencën dhe mundësinë për të manipuluar me fletëvotime këto të shtypen nga operatori ekonomik dhe të njëjtat, të dorëzohen dhe t'ua mundësojmë atyre që janë në këto institucione që të votojnë në ditën e zgjedhjeve....

Ne, rekomandojmë që të miratohet ky rekomandim i KOZ-it...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit z. Elshani, a ka dikush diçka lidhur më këtë pike? Atëherë, e hedhim në votim. Kush është për ? Miratohet rekomandimi për ndarjen dhe paketimin e fletëvotimeve për votuesit neper institucione kategoria e dytë...

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përfundimtar për Certifikimin e Listës Përfundimtare te Votuesve për zgjedhjet lokale 2021.

Arianit Elshani: Pika e radhës ka të bëjë me raportin përfundimtar për certifikimin e listës përfundimtare të votuesve për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 17 tetor. Lista përmban: 1.885.448 emra të votuesve që është për 90 mijë votues më shumë në krahasim më zgjedhjet e parakohshme për kuvendin e republikës së Kosovës që janë mbajtur më 14 shkurt 2021. Kjo shifër, mund të konsiderohet e lartë mirëpo, arsyeja mbrapa kësaj shifre qëndron për shkak se personat që kanë votuar në zgjedhjet e fundit votimin jashtë vendit më postë, kësaj radhe janë transferuar brenda listës së Kosovës dhe, kemi 15 mijë votues që janë në listën e votuesve jashtë vendit. Prandaj, është kjo shifër.

Votuesit e rinjë që do t'i kemi për këto zgjedhje të 17 tetorit në raport më 14 shkurtin, janë: 24.697 votues të ri që kanë arritur moshën 18 vjeçare dhe që do të votojnë për herë të parë në zgjedhjet lokale...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit. A do të diskutoj dikush ?

Sami Kurteshi : Faleminderit z. Kryesues: unë, po e bëj një pyetje nëse e kam kuptuar drejt se nuk jam i sigurt që kam kuptuar drejt, por a do të thotë që në këtë listë janë edhe emrat e personave që me 17 tetor i mbushin 18 vite ? Pra, nuk ka nevojë në atë drejtim që të rifreskohet, pra e vetmja listë që mund të vijë nga ARC-ja, është vetëm me persona që kanë hequr dorë nga shtetësia dhe personat e vdekur; Këta, janë në listë...

Ilir Gashi: Jo, e tha me doket drejtori i zyrës z. Buleshkaj më herët më vjen mirë që është evidentuar...janë përfshirë të gjithë ata kandidatë për asamble, qoftë edhe për kryetar komune të cilët, e kanë ndërruar vendvotimin nga një komunë në një komunë tjetër dhe po besoj plotësisht që, një diçka e tillë është zgjidhur dhe janë të përfshirë në këtë listë, dhe të tjerët dhe po me këtë numër është lista votuese jashtë Kosovës...Për këtë arsye, lista doket që është e fryrë se ka 1 milionë e 800 mijë votues por, edhe tjera është që duhet të jemi të vetëdijshëm që pastrimi nga njerëzit e vdekur nuk është i mundshëm në atë masë, sa është numri i votuesve të ri që i mbushin 18 vite....t

Arianit Elshani: Lidhur më çështjen që u ngrit edhe për votues jashtë vendit, pra kjo listë është lista përfundimtare e votuesve e cila do të jete në listat që do të jene në këshillat e vendvotimit dhe kjo sigurisht përmban edhe emrat e personave që nuk janë të regjistruar për votim jashtë vendit në raport më 14 shkurtin tani është një numër shumë më i vogël i votuesve të cilët kanë aplikuar për të votuar jashtë vendit pra është 14.500 votues pra janë ata të cilët janë hequr nga kjo liste. Tash kemi 90 mijë persona të cilët janë përfshirë kështu që është teknike nuk besoj që ka interes shumë por për neve është shumë e rëndësishme që të dimë pse është ky numër kaq i madh pra kjo është.

Në raport më emrat e personave që kanë vdekur një pjese e madhe e këtyre që jemi këtu në përbërje të KQZ-së është gjë që kemi kërkuar që nga dita e pare që kemi ardhur në KQZ-ë pra në vitin 2020 kur kemi kërkuar që këta emra të atyre personave që kanë ndërruar jete të largohen nga lista e votuesve dhe ne kemi marr iniciativë që te krijohet edhe një marrëveshje bashkëpunimi më ministrin e punës dhe mirëqenies sociale pastaj bashkërisht më komisionet tona komunale të zgjedhjeve të zyrtareve tanë të lart komunal që ti largojmë dhe te identifikojmë personat që kanë ndërruar jete po që figurojnë në listat tona dhe kjo është arritur në mase të konsiderueshme me kapacitetet që kemi pasur në dispozicion.

Sigurisht që këtu, mundet të na ndihmojnë institucionet tjera mund të na ndihmoj agjencioni i regjistrimit civil mund të na ndihmojnë komunat që ato lista pra listat e regjistrimit civil të përditësojnë më baza qofte mujore që ne të kemi një ekstrakt të pastër pa emrat e personave që kanë vdekur sepse kjo pastaj rrite mundësin që të manipulohet ky proces në ditën e zgjedhjeve prandaj ky është një numër duke pasur parasysh konsiderate të gjitha ato vendimet bashkërisht këtu në KQZ-ë .

Alim Rama: Unë mendoj që të cekem edhe rekomandimet që janë në listë sepse, rekomandimet janë shumë të qarta dhe posaçërisht unë e kisha propozuar të ministria e punëve të brendshme duhet të beje lidhjen e bazës të dhënave të departamentit të prodhimit të dokumenteve dhe me bazën e të dhënave të departamentit të gjendjes civile në aspektin e adresave që pastaj do të reflektojnë në Problemi kryesorë që na del neve, se këto dy baza nuk janë të ndërlidhura dhe jo të gjitha adresat janë në

sistem, kjo na paraqit probleme me kandidatë! Po ashtu, reflekton njëjte dhe tek votuesit, kështu që unë rekomandoj që menjëherë mbas procesit zgjedhor, si KQZ-ë të vazhdoj bashkëpunim me ARC, apo ministria e punëve të brendshme...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit z. Rama. Nëse nuk ka dikush diçka tjetër e hedh ne votime. Kush është për certifikimin e listës përfundimtare të votuesve. Me vota unanime, certifikohet lista përfundimtare e votuesve për zgjedhjet lokale 2021.

Të ndryshme !

Florian Dushi: Nëse ka mundësi që Krye shefi dhe Drejtori me u ulur në vendin e vet sepse, përveç që s'jane antarë të KQZ-së, po kemi vështirësi me e pa se kush po diskuton, kështu që të dalin në vendin e tyre...n.

Kreshnik Radoniqi: A pajtoheni a të ja nisim prej fillimit mbledhjes, në mbledhjen e rrodhes na dilni për ballë...